Gjithashtu ujrata e shiut mblidhen nga kollonat vertikale te realizuara me tuba plastike qe zbresin nepermjet fasades dhe e dergojne ujin ne kanalizimin e ujrave te bardha qe eshte ndertuar perreth objektit. Zbatimi i punimeve per shkarkimet e ujrave te bardha sanitare dhe ujrave te zeza eshte realizuar sipas projektit te miratuar dhe konform kushteve teknike ne fuqi.

### **Intalimi i sistemit te mbrojtjes ndaj zjarrit**

Ky sistem eshte llogaritur me shuarje me uje mbasi eshte sisemi me i pershtatshem per shuarje te zjarreve te klases A, kryesisht me material te ngurte te djegshem).Sistemi H/Z funksionon me 1kolone te vecante qe furnizon zonen e perzgjedhur sipas Lay –out-it te planimetrive ne zbatim te kriterit projektues.

Hidrantet vendosen ne hyrje te objektit ne menyre te tille qe cdo pajisje te mbroje jo me shume se 100 m2 si dhe cdo pike e zones se mbrojtur nga zjarri te mos jete me larg se 30m nga ato. Ato furnizohet me uje nga rezervuare e katin perdhe te objektit.

**Hartoi dhe punoi:**

**SHOQERIA "HTS COMPANY"shpk**

**Ing. Hidro Kujtim Bilaj**

**Lic Nr.K0177/4**

## **RELACION TEKNIK KONDICIONIMI**

### **OBJEKTI:**

**“RIKONSTRUKSION I AMBIENTEVE TË SHËRBIMIT NË  
FUNKSION TË AMFITEATRIT”**

**SHOQERIA "HTS COMPANY"shpk**

**Ing. Mekanik Alma Mitre (Qirici)**

**Lic. Nr. M.1470/2**

## RELACION TEKNIK

### SISTEMI I NGROHJES DHE I FTOHJES

#### Hyrje

Ambientet e ketij objekti jane te perbera nga zona me tipologji te njejte, ne te cilat ushtrohen aktivite qe dallohen shume pak me njera tjetren, te cilat kane te njejtin qellim te perbashket per sa i perket sigurimit te nje komoditeti banimi.

Keto kerkesa jane parapare ne propocion me standartet e jeteses si dhe me ndikimin e tyre ne koston e ndertimit.

#### Karakteristika arkitektonike

Ambientet dhe strukturat arkitektonik eshte e ndryshme ne funksion te dimensionimit te tyre dhe lokalizimit ne projekt. Konfigurimi eshte i kompozuar ne kater zona te ndryshme nga pikpamja e konstruksionit, funksionalitetit dhe pajisjeve te instaluara.

#### Konditat e projektimit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mireqenia fiziologjike) qe mund te sigurojme brenda ambienteve jane ne vartesi te destinacionin te perdorimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdorur si referenca per projektin.

#### *Vendndodhja*

Tirane

#### Per periudhen e grohjes - Dimer

Temperatura e brendshme llogaritese

**20 – 22 °C**

Lageshtia relative e brendshme

40 – 50 %

Levizja e ajrit ne mjediset e punes

0.13 - 0.15 m/sek

Qarkullimi i brendshem

1.0 – 1.5 nderime/ore

Grade dite te ngrohjes

995 grade-dite

Periudha e ngrohjes

01/11 – 26/03

Ditet e ngrohjes

222 dite

Temperatura mesatare e Janarit

4.9 °C

Lageshtia relative mesatare e Janarit  
90 %  
Temperatura e jashteme llogaritese  
+1 °C

#### **Per periudhen e freskimit – Vere**

Temperatura e brendshme llogaritese  
**25 – 27 °C**  
Lageshtia relative e brendshme  
60 – 70 %  
Levizja e ajrit ne mjediset e punes  
0.16 - 0.23 m/sek  
Qarkullimi i brendshem  
1.0 – 1.5 nderime/ore  
Temperatura maksimale e muajit te nxehte  
40 °C  
Temperatura mesatare e muajit te nxehte  
35 °C  
Lageshtia relative mesatare e muajit te nxehte  
55 %

Sistemi i ngrohjes / ftohjes se ambientit eshte planifikuar te punoje: ne mposhtjen e humbjeve te ngarkesave termike me ane te Kondicionereve te montuara ne mure. Burimi i energjise do te sigurohet nga makinerite e jashtme (kompresoret e gazit) te cilat do te jene version pompe nxehtësie me Inverter e tipit Multi Split.

#### **Humbjet e nxehtesise**

Per te anlizuar ne menyre te kujdeseshme humbjet e nxehtesise jane konsideruar te gjithë faktoret qe influencojne per shkak te orientimit me horizontin, afersia me ambientet, karakteristikat termofizike te mureve rrethues, dritareve, dyshemese, tavanit etj.

Humbja e nxehtesise influencohet edhe nga popullimi i ambienteve, ndriçimi, ventilimi natyral i ajrit etj.,

Te gjitha te dhenat e mesiperme kane sherbyer per kalkulime nepermjet programit kompjuterik (software – it) te humbjeve ne stinen e dimrit/veres si dhe specififikimet teknike te pajisjeve qe duhen përdorur.

Nga pikpamja e kapacitetit termik te pajisjve nenvizojme se kapacitet per pikun e ngarkeses variojne ne menyre te konsiderueshme gjate dites bazuar ne variacionin e okupimit te ambienteve gje qe ka qene e parashikuar jo e rregullt. Per te shmanguar super dimensionimin e kapaciteteve te pajisjeve jane analizuar paraprakishte efektet si dhe parashikimi paraprak i konsumit energjetik.

#### **Perzgjedhja e sistemit dhe tipologjia**

Karakteristikat e sistemit te perzgjedhur jane parashikuar ne vartesi te kritereve te meposhtem:



- Fleksibilitet gjate gjithë kohës së shfrytëzimit që do të thotë që kapacitet e sistemit të sigurojnë performancë variabile gjate ditës dhe në sezona të ndryshme.
- Fleksibilitet në kapacitet e terminaleve në ambientet e destinuara.
- Të jete i aftë të sigurojë kondita në përputhje me ato të parshikuara në kriteret e projektimit për të siguruar një mirëqenie fiziologjike të kënaqshme.
- Kosto të ulët përdorimi dhe mirëmbajtje.

Tipologjia e përzgjedhur është sistemi Multi Split me inverter, .

Ky sistem siguron kërkesat e ambienteve për energji termike (ngrohje, ftohje, ajër të freskët). Kontrolli zonal do të sigurojë dhënie, ndërprerjen si dhe modulimin e kërkesës për energji termike në funksion të ngarkesave termike, në funksion të fashave orare të përdorimit gjate 24 orëve të ambienteve me vecori tipike përdorimi, duke realizuar kështu përdorimin efiçient të konsumit të energjisë.

Impianti do të përbehet nga këto komponente kryesore:

- ✓ Njësia e jashtme – Chiller me zgjerim direkt Multi Split, version pompe nxehtesie me Inverter;
- ✓ Tubacionet e shpendarjes;
- ✓ Njësia e brendshme – kondicioner Multi Split me Inverter.

Kontrolli i temperaturave të ambienteve do të sigurohet nepermjet termostave të ambienteve që komandojnë makineritë respektive.

#### ■ Kontrolli zonal

Ky kontroll do të sigurojë dhënie, ndërprerjen si dhe modulimin e kërkesës për energji termike në funksion të ngarkesave termike, në funksion të fashave orare të përdorimit gjate orëve të punës në ambientet me vecori tipike përdorimi, duke realizuar kështu përdorimin efiçient të konsumit të energjisë. Të gjithë terminalët do të kontrollohen nepermjet termostateve të ambienteve.

#### ■ Rregullimi klimatik

Sistemi i rregullimit klimatik automatik ka një impakt të konsiderueshem në lidhje me funksionimin dhe konsumin energjetik. Temperaturave të ambienteve mund të rregullohet individualisht ose të centralizuar prej përdoruesve brenda një intervali të limituar (neper termostateve të ambientit ose një rregullator qendror), por funksionimi normal i gjeneruesve të energjisë termike sikurse janë kompresoret e gazit do të realizohet nepermjet këtij sistemi.

Mbikqyrja e sistemit na lejon të menaxhojmë të gjitha shërbimet dhe sistemin në tersi.

Funksionet esenciale që mund të realizojë sistemi do të jënë:

- Nisja dhe ndalimi i funksionimit të pajisjeve në baze të një programi kohor të paravendosur;
- Kontrolli i parametrave të parashikuara;
- Transmetimin e informacioneve për demtime të mundshme ose funksionimin jo normal të pajisjeve;
- Program mirëmbajtje.

#### Makineri dhe pajisje

Sic folem më lartë sistemi i përdorur për ngrohjen e objektit është bere nepermjet sistemit Multi Split me Inverter. Sistemi Multi Split me Inverter është një sistem me efiçencë shumë të

larte ne kursimin e energjise dhe te hapsirave qe ze. Sistemi inovativ Multi Split me Inverter eshte nje revolucion ne sektorin e ngrohjeve dhe kondicionimt te ndertesave duke siguruar performance te larte ne ambiente sipas kerkesave te personave qe e popullojne kete ambient. Sistemi i parashikuar eshte i lehte ne instalim, perdorim dhe siguron nje kosto perdorimi sa me te ulet te sistemit. Pajset e perdorura jane Multi Split me Inverter me karakteristika teknike si me poshte:

#### *Njesi e jashteme Kompresor Multi Split Inverter*

Paisja e jashteme e montuar mbi taracen e ambientit teknik te ri te kaldajes eshte nje paisje version pompe nxehtesie me inverter, e cila suporton lidhjen e 64 paisjeve ne seri, me nje sistem tubash deri ne 1000 m gjatesi totale.

Fleksibiliteti I ketij sistemi eshte dhe ne perdorimin e gjatesise me te larget te nje paisje qe eshte 165 m, ku trupi I punes eshte Gaz R410A, me poshte jepen karakteristikat teknike te paisjes:

#### *Kondicioner Multi Split mural*

Keto pajisje punojne me ekspansion direkt ne variantin pompe nxehtesie, jane te lidhura ne seri me njera tjetren me ane te kolektorit te shpendarjes dhe me Y-ypylona lidhen me kompresorin.

#### **Uljen e nivelit te zhurmave te terminaleve**

Nepermjet valvules elektronike me zgjerim (Linear electronic expansion valve "LEV") duke bere rregullimin e prurjes se rrymes neper terminale, kjo do te sillte automatikisht uljen e zhurmes se terminaleve neper ambiente.

#### *Tubot dhe rakorderite*

Tubot e perdoruara jane tre tipe:

- Tipi i pare eshte tubo bakri Cu;
- Tipi i dyte eshte tubo PPR per largimin e kondenses;
- Tipi i trete eshte tubo PVC i cili dhe ky sherben per largimin e kondenses.

#### *Tubot e Gaz-it / Leng-ut jane me material baker Cu:*

Tubot e bakrit Cu per agjente ftohes R410A jene te destinuara per perdorim kondicionimi dhe do te furnizohen se bashku me pajset, ndersa rakorderite do te jen prej bronzi.

Lidhjet do e realizohen me saldim ose me shtrengim.

Standardi:	UNI EN 378;
Presioni i çarjes:	18.9 - 93.17 MPa (ne varsi te tubit);
Presioni i punes:	4.53 - 23.29 MPa (ne varsi te tubit);
Trupi i punes:	R410A.

*Tubot e kondensimit do te jene pjeserisht me tubo polipropilene PPR me keto karakteristika:*

Densiteti i PPR:	0,9 g/cm <sup>3</sup>
Temperatura e saldimit:	146 grade Celsius
Percjellshmeria termike ne 22 grade:	0,23 W/mK
Koeficienti i zgjerimit linear:	1,5 x 0,0001 K
Elasticiteti ne 22 grade:	670 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca ne rjedhje ne 22 grade:	22 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca ne shkaterim ne 22 grade :	35 N/mm <sup>2</sup>

*Pjesa tjeter e tubove te kondensimit do te jene me tubo polipropilene PVC me keto karakteristika:*

Specifikimi i gravitetit: D792);	1.4 +/- 0.2 g/cm <sup>3</sup> (metodologjia e testimit sipas ASTM)
Fortesia me metoden Rockwell: D785);	110 – 120 (metodologjia e testimit sipas ASTM)
Elasticiteti ne 22 grade:	420 N/mm <sup>2</sup> .

**SHOQERIA "HTS COMPANY" shpk**

**Ing. Mekanik Alma Mitre (Qirici)**

**Lic. Nr. M.1470/2**

**“RIKONSTRUKSION I AMBIENTEVE TË SHËRBIMIT NË  
FUNKSION TË AMFITEATRIT”**

**Raporti i Mbrojtjes Ndaj Zjarrit**

Hartoi dhe punoi:

SHOQERIA "HTS COMPANY" shpk

Ing. MKZ Xhesila Myzyri

Cert Nr.62, date 14.09.2024

## PËRMBAJTJA

1.1	Pershkrimi i Impjantit MNZ.....	1
1.2	Grupi i pompimit .....	2
1.3	Rezerva e ujit te impjantit MKZ .....	2
1.4	Tubacionet shperndares dhe lidhjet.....	2
1.5	Hidrantet.....	2
1.6	Shuarresit portabel te zjarrit.....	3
1.7	Mbrojtja pasive ndaj zjarrit .....	3

## 1.1 Pershkrimi i Impjantit MNZ

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri i objektit “Rikonstruksion i ambienteve të shërbimit në funksion të Amfiteatrit”, do të realizohet në baze të standarteve dhe normave lokale si dhe ato të vendeve të Komunitetit Europian.

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit respekton kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat/standartet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e përdorura në këtë projekt janë paraqitur në vijim:

- **Ligji nr. 152/2015** “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

- Rregullore “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të cdo lloji “**Vendim nr.162 date 19.4.1965**, e ripunuar;

-**Udhëzim i Ministrisë të Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015** “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe leshimin e akteve teknike”;

<b>EN 13501</b>	Fire classifications of construction products and building elements (all parts)
<b>IEC 79-10</b>	Area Classification Guidelines
<b>EN 2</b>	Classification of fires
<b>EN 1838</b>	Lighting applications – Emergency lighting
<b>EN 1366</b>	Fire resistance tests for service installations
<b>NFPA 10:</b>	Standard for Portable Fire Extinguishers, 2010 edition.
<b>EN 3-1:</b>	Portable fire extinguishers, Description, duration of operation, class A and B fire test.
<b>EN 3-4:</b>	Portable fire extinguishers. Charges, minimum required fire.
<b>EN 3-5:</b>	Portable fire extinguishers. Specification and supplementary tests.
<b>EN 3-7:</b>	Portable fire extinguishers. Characteristics, performance requirements and test methods.
<b>BS B2:</b>	Fire Safety – Dwelling houses – Volume 1

Gjatë procesit të aplikimit të sistemit duhet që të kontaktohet me autoritetet vendore të MKZSH për të siguruar një testim dhe aprovim të këtij instalimi.

Duke marrë në konsideratë karakteristikat e objektit si dhe destinacionin e tij, do të përdoren pajisje shuarese të zjarrit si më poshtë :

- hidrante: për ambientin e objektit 1 katë njësi shërbimi Servis , hidrante jashtë ose brenda murit me kaseta.
- shuarese portabel me shkumë dhe pluhur ABC , në Servis.

Faktoret përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë natyra dhe përmasa e zjarrit, madhësia e zonës që do të mbrohet, mundësia e përhapjes me shpejtësi të zjarrit, kërkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

Objekti “Rikonstruksion i ambienteve të shërbimit në funksion të Amfiteatrit” do të trajtohet si të gjitha godinat duke u mbështetur në rregulloren e PMNZSH-së dhe urdhrin nr.425 date 24.7.2015

Pajisjet e shuarjes së zjarrit duhet të disponojnë sasine komplete të ujit të nevojshëm për shuarjen e zjarrit në momentin kur ai shfaqet. Kjo do të realizohet nëpërmjet instalimit të hidranteve të ujit; hidrantet nga ana e tyre furnizohen me sasine e duhur të ujit si dhe presionin e mjaftueshëm.

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri parashikon edhe lidhjen jashtë me grupet e specializuara të skuadrave të mbrojtjes nga zjarri në, përputhje me normën UNI 11779 PN12.

## **1.2 Grupi i pompimit**

Grupi i pompimit te impjantit kunder zjarrit do te vendoset ne ambientin e Dhomes teknike te vendosur nen pandusin ne krahun e djathte, dhe do te jete ne perputhje me normativen UNI 9490.

Ne raste zjarri, me renjen e presionit ne rrjetin kunder zjarrit nen nje nivel te caktuar, kontrollori elektronik do te aktivizojte automatikisht pompen elektrike te sherbimit si edhe te transmetoje nje sinjal zjarri ne sinjalizuesit vizuale. Ne rast se pompa elektrike e sherbimit nuk starton per cfaredo arsye, motopompa hyn ne funksion me renjen e presionin nen nje nivel te paracaktuar. Funksionet e saj jane te njejta me funksionet e pompes elentrike te sherbimit, por sherben si nje rezerve ne rast mosfunksionimi te pompes elektrike te sherbimit ose mungese te energjise elektrike.

## **1.3 Rezerva e ujit te impjantit MKZ**

Kerkesat per depozitim te ujit per mbrojtje kunder zjarrit jane bazuar ne konsiderimin qe ne nje kohe te mundshme mund te perballemi me rrezikun e çfaqjes se zjarrit. Sasia e ujit qe kerkohet eshte barabarte me kerkesat per uje te vazhdueshem per shuarjen e zjarrit si dhe kohen ne dispozicion qe duhet per eliminimin e tij. Kjo sasi percakton depoziten e nevojshme te ujit ne dispozicion per mbrojtjen nga zjarr per nje autonomi prej 60 minutash (2000 litra ne dispozicion te impjantit MNZ).

Projekti garanton nje sasi uji qe te furnizojte 1 hidrante te godines te pozicionuar ne vendin me te pafavorshem me sasi uji minimale prej 120 l/min, me presion ne dalje prej 3 bar dhe nje kohezgjatje prej 60 min.

Depozita e ujit do te jete ne formen e rezervuarit xingato te ujit , e vendosur ne hapsiren e ambientit duke perfshire lidhjet, menyren e furnizimit me uje, tubacionet lidhese, galexhantet mekanik etj, si dhe te gjitha kerkesat per te siguruar nje funksionim normal. Rezervuari duhet te pajiset me tregues niveli elektronik si edhe mekanik vizual. Këto tregues duhet te sinjalizojne për renjen e nivelit te ujit ne rezervuar nen nje vlere te percaktuar.

## **1.4 Tubacionet shperndares dhe lidhjet**

Diametrat dhe gjatesite e tubacioneve te impjantit MKZ, sikurse e theksuam me siper, do te jene ne vartesi te volumit te ujit dhe te gjitha lidhjet e rrjetit te brendshem te furnizimit me uje do te kalkulohen me te njejten metodologji sikurse ato te furnizimit me uje sanitar. I gjithe rrjeti i brendshem do te pergatitet prej tubo çeliku pa tegel. Tubacionet me filetim duhet te shmangen.

Tubacionet e çelikut duhet te instalohen mbi toke me rrjetin e furnizimit e. Kur uji paraqet elemente korrozive ose kur tubot jane ne zhytje te perhershme, tubacionet e çelikut te seksionit te thithjes duhet te galavanizohen ne brendesi ose te lyhen perpara instalimit te tyre.

Rrezja minimale e kthesave te tubove duhet te jete sa trefishi i diametrit te tubit. Tubacionet duhet te jene ancoruar dhe te siguruar per te minimizuar demtimet dhe vibrimet. Suportet duhet te sigurojne gjithashtu nje ekspansion termik normal te tubacioneve. Ne te gjitha rastet duhet te parshikohet mbrojtja nga korozioni.

## **1.5 Hidrantet**

Ne objektin dy kat, vile do te vendosen hidrante UNI 45. Kaseta e hidrantit do te vendoset ne pozicion te dukshem dhe e pajisur me sinjalistiken perkatese. Leshuesi dhe tubacioni i ujit jane vazhdimisht te lidhura me kolonat e furnizimit me uje.

## 1.6 Shuarresit portabel te zjarrit

Faktoret percaktues qe duhen marre ne konsiderate gjate projektimit te mbrojtjes aktive nga zjarri kane qene:

Natyra dhe permasa e zjarrit dhe madhesia e zones qe do te mbrohet

Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;

Kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi

Ne kete objekt eshte parashikuar perdorimi i shuarresve portabel te zjarrit dhe pikerisht:

shuaresve portabel zjarri , EN3, pesha 6 kg, klasa 34A 233BC;

shuarres zjarri me CO2, EN3, pasha 5 kg, klasa 113B;

Shuaresi i zjarrit portabel do te mirembahen dhe testohen te pakten ne cdo vit nga autoritete te licensuara per kete qellim.



*Shuarres zjarri portabel me Pluhur (klasa 34A233BC)*

Shuaresit e zjarrit portabel me CO2 do te mirembahen dhe testohen cdo 6 muaj nga autoritete te licensuara per kete qellim.

## 1.7 Mbrojtja pasive ndaj zjarrit

### 1.7.1.1 Masat pasive te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi

Pjese e Mbrojtjes pasive eshte edhe vendosja e objektit dhe lidhja e tij me objektet perreth, rruget e kalimit te automjeteve zjarrfikese etj .Pjese e mbrojtjes nga ana Arkitektonike.

Objekti “Rikonstruksion i ambienteve të shërbimit në funksion të Amfiteatrit” gjendet ne Parkun e Liqenit Arificial të Tiranës, Bashkia Tirane. Godina sipas pozicionit ku do te rikostruktohet dhe do të respektojë distancat e sigurisë nga objektet e tjera përreth saj . Këto distance diktohen nga shkalla e qëndrueshmërisë ndaj zjarrit që do të të ketë ndërtesa dhe që janë të përcaktuara në normat e mbrojtjes nga zjarri. Rreth saj ka hapsira të lira , të cilat lejojnë levizjen e kalimit të automjeteve zjarrfikëse te cilat jane te gjëra dhe të përshtatëshme për kalimin e tyre për aritjen në vend ngjarje Sheshi mbi te cilin ndertohet Vila ploteson kerkesat dhe standartet teknike per kete objekt.

Disa nga kushtet që duhen respektuar janë

- Duhet të ketë rrugë kalimi për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse.
- Nuk duhet të ketë rrugë pa krye.
- Në rast zjarri automjetet dhe paisjet zjarrfikëse e të shpëtimit duhet të afrohen dhe veprojnë të paktën nga dy anë të objekteve.
- Stacioni zjarrfikës më i afërt duhet të vijë në ndihmë jo më pak se 10-15 min.



**Kjo godine nuk rrezikon objektet e tjera rreth saj dhe as nuk rrezikohet prej ketyre objekteve. Godina dhe per rrjedhoj dhe infrastruktura per rreth saj plotson kerkesat per mbrojtjen nga zjarri e shpetimin te percaktuara ne “Rregulloren mbi masat mbrojtese kundra zjarrit ne projektimin e ndertesave te cdo lloji.**

Pjese e mbrojtjes pasive eshte dhe konstruksioni i objektit , materialet e perdorura etj qe kanë të bëjëne me qëndrueshmërinë ne lidhje me normat faktike dhe to të lejuara nga rregullorja e PMNZSH-së.

Në punimet e zbatimit do të përdoren materiale në zbatim të kushteve teknike të zbatimit KTZ si për rifiiturat ashtu edhe për rrjetin inxhinierik përkatës.

Veshja e jashtme e ndertesës, ambjenteve, tavanit dhe dyshemese nuk jane te shtruara apo dekoruara me materiale te djegeshme. Muret kufizuese dhe materialet e tjera te fasadës se ndertesë sikurse edhe soleta b/se ndertesës jane elemente konstruktiv te padjegshem.

Me konkretisht, qendrueshmeria REI e strukturave ndertimore paraqitet ne tabelen e meposhtme:

Struktura ndertimore	Djegshmeria	Shkalla minimale REI e
Muret e jashtem	Te padjegeshme	5 ore
Muret ndares	Te padjegeshme	1,5 ore
Kolonat mbajtese	Te padjegeshme	4.5 ore
Soleta e godines	Te padjegeshme	3,3 ore

Nga sa me siper rezulton se keto struktura e kane qendrueshmerine minimale REI me te larte se sa kerkohet ne raste te tilla nga normat teknike te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit (90 minuta per godina te tipit C).

Evakuimi i njerëzve dhe personelit

Per te rritur garancine per jeten e njerezve te pranishem, kur ata ndodhen ne kushtet e nje zjarri dhe per te bere te mundur nje evakuim te shpejte dhe te sigurte te tyre nga vendi i ndodhjes eshte e detyrueshme qe daljet dhe rruge kalimet evukuese, sidomos hapsirat dhe kalimet ne to te mbahen gjithnje te lira. Ato duhet te behen prezent edhe nepermjet tabelave treguese fosforeshente dhe me ndricim sikurse parashikohet ne projektin elektrik te MNZSH-se. pjese keto nga projekti konstruktiv i MNZ .

Masat e pergjithshme te mbrojtjes nga zjarri perfshijne:

- pozicionimin e shenjave qe paraqesin pozicionet e sharresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergences;
- largimin e materialeve te ndezeshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre nje vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit;
- mbajtjen te lire te rrugeve te largimit;
- mirembajtjen e kujdeseshme dhe kontrollin e vazhdueshem te instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla;

#### **1.7.1.2 Ndricimi artificial i emergences**

Ndricimi artificial i emergences do te jete ne perputhje me EN 1838 “Lighting applications-Emergency lighting”. Ky standart do te aplikohet edhe gjate punimeve te instalimit.

Ndricimi i emergences duhet te garantoje ne rruget e largimit nje ndricim minimal prej 15 lux, i matur ne nivelin e dyshemese.

Ne rast hyrje ne funksionim te ndricimit te emergences ai duhet te qendroje ne veprim per nje kohe prej te pakten 90 minuta.

### 1.7.1.3 Shenjat e daljeve te sigurise

Shenjat e daljeve te sigurise duhet te jene ne perputhje me EN ISO 7010 "Graphics symbols - Safety colors and safety signs - Registered safety signs".

Nje tabele e cila tregon drejtimin e daljes se Emergences do te vendoset ne cdo kat.

Ajo do te jete e ndricuar nepermjet LED, ne perputhje me normen BS 5266-1:2011 dhe BS EN 60598-2-22 dhe duhet te permbaje LED dhe baterine, emetimi: 100 Lumens.

Tabela duhet te jete per perdorim ne ambjente te brendeshme (mbrojtje IP42) duhet te mbetet e ndricuar per te pakten 3 ore ne mungese te energjise elektrike.



*Shenjat e daljeve te sigurise*

**HARTOI DHE PUNOI:**

**SHOQERIA "HTS COMPANY"shpk**

**Ing. MKZ Xhesila Myzyri**

**Cert Nr.62, date 14.09.2024**